

Agron ISLAMI

DOSJA E HYSEJN FUAD PASHË GJINOLLIT (1866 - ...?)

Tridhjetë vjet pas Reformës së Tanzimatit (1839), administrata osmane nën drejtimin e Sulltan Abdylhamitit II (1876-1909), filloi të hartojë defterët e punonjësve të saj. Këta regjistra u përpiluan nga komisioni i themeluar nga vetë Sulltani. Kështu për herë të parë në historinë e administratës osmane me përjashtim të personelit të klasës së ilmijs (ku bënin pjesë, ylemaja, personeli i gjakatava etj.), atij ushtarak dhe policor, u bë regjistrimi i nëpunësve shtetërorë myslimanë e jomyslimanë.

Fillimisht, ky fond i biografive u krijua nëpërmjet hartimit të jetëshkrimeve nga vetë punonjësit, e që në fund të çdo cv-je dëshmonin se, të dhënat e tyre janë të sakta dhe mbajnë përgjegjësi për vërtetësinë e tyre. Kështu, këta defterë të hartuar nga fundshekulli XIX, formojnë dosjet e personaliteteve të shekullit XIX dhe fillimshekullit XX. Ku mund të gjejmë informacione mbi emrin, prejardhjen, pseudonimin, emrin e prindit, profesionin, statusin arsimor, vendet e punës, vlerën e pagës, ngritjet në pozitë, shpërblimet e marra nga shteti etj. Në një mënyrë është një dosje e plotë e nëpunësit që paraqet gjithë veprimtarinë jetësore, duke përfshirë të arriturat dhe dështimet.

Dokumenti biografik që kemi përzgjedhur të botojmë të përkthyer, gjendet në Arkivën Presidenciale të Republikës së Turqisë (*Başkanlık Osmanlı Arşivi*/ fondi i biografive (*Sicil*) të shërbyesve me nr. 00023/570), ofron informacione të rëndësishme për njërin nga pasardhësit e familjes së njohur shqiptare (Gjinollajt) që udhëhoqën me vilajetin e Kosovës, kryeqendër e së cilës ishte Shkupit, Prizreni dhe Prishtina. Ky pjesëtar i Gjinollajve, i lindur në nëntor të vitit 1866 në kryeqendrën e Portës së Lartë,

ishte Hysejn Fuad Pasha, i biri i Abdurrahman Galip Pashë Gjinollit. Ky i fundit, ishte nga Mytesarrifët e Beratit, Sirozit etj. dhe njihet për kontribute në infrastrukturën e qytetit të tij të lindjes (Prishtinës), siç është rasti me Rushdijën e Parë (shkollë e mesme e ciklit të ultë) në Prishtinë, të cilën e ngriti në vitin 1861.¹

Siç edhe mund të shohim nga dosja e tij, Hysejn Fuad Pasha, edukimin dhe arsimimin fillor dhe të mesëm e kishte marr në shkollën perandorake (mekteb-i Sulltani) dhe atë ushtarake në lagjen Fatih të Stambollit. Shkruante gjuhën osmane, ndërsa fliste gjuhën shqipe, osmane dhe atë bullgare. Ai kishte njohuri edhe nga gjuha arabe, perse dhe frënge.

Si rezultat i prejardhjes, ai gjithë karrierën e tij e kishte e bërë në departamente të ndryshme të shtetit. Qysh në moshë të re, kishte filluar me stazhin në njërën nga zyrat më të rëndësishme të administratës osmane të shekullit XIX, siç ishte ajo e Tanzimatit, ku hartoheshin projektligjet dhe marrëveshjet ekonomike që shteti i bënte me kompani (firma) të huaja. Për të vazhduar me kontribute në fushën e akademisë ushtarake, ku Hysejn Fuad beu kishte treguar aktivizëm të theksuar, sa që ishte shpërblyer me medaljone perandorake (siç ishte praktikë e kohës). Ai ishte pjesëmarrës në Betejën e Domokos (1897) kundër grekëve, ku kishte luajtur rol të rëndësishëm edhe në mobilizimin e mbi një mijë (1 000) vullnetarëve nga rajoni i Prishtinës dhe Mitrovicës, e që siç nënkuptohet nga dosja e tij, këta pjesëmarrës shqiptarë kishin ndryshuar rrjedhën e kësaj beteje të rëndësishme për osmanët. Kontributi i tij në administratën e Perandorisë Osmane bëri që ai në moshën 34-vjeçare të emërohet bejlerbej (guvernator) i Rumelisë (tokat osmane në Evropën Juglindore/Ballkani i sotëm). Po ashtu, si rrjedhojë e personalitetit të tij prej nëpunësi e burokrati, më 12 nëntor zgjidhet deputet i Prishtinës në Parlamentin e dytë osman. Vlera shkencore e dokumentit prej dosje e Fuad Pashë Gjinollit, shpërfaq informacion burimor mbi prejardhjen e familjes së Gjinollajve, që dëshmon se ishte pjesëtar i një dinastie (*hanedan*) që siç ndodhi me Bushatllinjtë e Shkodrës, Begollajt e Pejës, Salihpashajt e Prizrenit, apo Gegozadet (Kryezinjtë) e Gjakovës, në shekullin XVIII u shndërruan në mirmiran (sundues) të sanxhaqeve shqiptare. Kështu, epiteti

¹ Shih. Agron Islami, “Prishtina gjatë kohës osmane (1455-1912)” në: [Agron Islami - Prishtina në histori \(prishtinanehistori.org\)](http://Agron-Islami-Prishtina-në-histori.prishtinanehistori.org), aksesë, 29.07.2024.

hânedân i Prishtinës (Pristine hânedân), i përmendur në dokument dëshmon vazhdimësinë e kësaj familjeje sundimtare qysh nga kohëra të hershme, e që deri më sot historiografia shqiptare dhe jo vetëm, nuk ka arritur që të ndjek lozën e Gjinollajve që sunduan me rrafshin e Kosovës dhe jo vetëm. Megjithatë, epitafet e Gjinollajve të zbuluara në Gjilan, po ashtu edhe një vendim i vitit 1763, bëjnë fjalë për Hysrev Begzaden, si i pari i kësaj familjeje.² Meqenëse, vendimi i fundit (i vitit 1763) flet për zgjedhjen Mustafasë, njëri prej djemve të Hysrevbegut si ajan/përfaqësues i Prishtinës, Vilçiterrinës dhe Novobërdës, mund të konkludojmë se, gjeneza e Gjinollajve duhet të jetë mes Prishtinës dhe Novobërdës, ngaqë sipas praktikës, ajan mund të zgjidheshin vetëm pjesëtarët që vinin nga paria e qytetit.

Përkthimi i përshtatur i dokumentit:

Hysejn Fuad Beu, i biri i Abdurrahman Galip Pashë Gjinollit nga dinastia (në dokument: hanedan) dhe pashallëku (në dokument: mir-miran) i Prishtinës.

U lind më datë 3 rexhep 1283 (11 nëntor 1866) në kryeqendrën osmane (Stamboll A. I.).

Pas shkollimit fillor dhe mësimi (plotësues A. I.) të shkencave fetare (islame A. I.), vazhdoi në Shkollën Ushtarake të Mesme (të ulët A. I.) të Fatihut (në Stamboll), ku mori mësim nga lëndët e gjuhës arabe, perse e frënge, pastaj nga gjeometria, gjeografia, matematika dhe kontabiliteti. (Mirëpo) si shkak i disa propozimeve mbi paqen (? A. I.) nuk kishte arritur të marr diplomën dhe të vishej me uniformën e të diplomuarit. Megjithatë, kishte marr mësim privat për gjuhët arabe dhe perse, po ashtu për një kohë kishte vazhduar shkollimin në Mektebin (shkollën A. I.) perandorak (në Stamboll). Shkruan gjuhën osmane dhe flet gjuhën shqipe dhe bullgare. Më datë 11 xhemazijelahir të vitit 1305 (23.02.1888 A. I.) me vendim të Këshillit të Lartë Shtetëror në

² Shih. Agron Islami, *Areali i Kosovës në kohën osmane: një histori socio-ekonomike e shekullit XVIII*, Prishtinë: Instituti i Historisë “Ali Hadri” - Prishtinë, 2024, f. 95-96. Për epitafin e Ahmet Bahtjar Begut (vdekja: 1800) dhe Mustafa Begut (vdekja 1811), shih. Agron Islami-Selim Selimi, *Epitafet në gjuhën osmane: deshifrimi dhe përkthimi i tyre, Regjioni i Gjilanit*, Vëllimi 3, Prishtinë: Fakulteti i Studime Islame, 2021, f. 24-27.

cilësinë e stazhierit (çirakut) filloi stazhin në zyrën/Departamentin e Tanzimatit³.

Më datë 11 dhjetor 1888, me sugjerimin e sekretarit të Këshillit të Lartë Shtetëror, shkëlqesisë Vasfi efendiu, u vendos që i përmenduri të vazhdojë në Departamentin e Tanzimatit.

Të lartpërmendurit më datë 13 prill 1890, i akordohet grada e tretë dhe më datë 1 shtator 1890 grada e dytë e klasës së dytë.

Më datë 19 janar 1895, iu akordua medalja (në dokument: nishan) Mexhidije nga grada e katërt me motivin e shërbimit të vyeshtëm.

Më datë 10 gusht 1895, iu dhuruan 50 kurushë, po ashtu më 28 shkurt 1897, iu dërguan 70 kurushë dhe 2 500 kurushë për ndihmën e dhënë në komisionin ushtarak. Më 7 prill të të njëjtit vit (1897 A. I.), iu akordua një medalje që i dedikohej pjesëmarrësve në luftën e Greqisë. Ky realitet ka gjetur pasqyrim në pusullën (shkresën zyrtare A. I.) e Këshillit të Lartë Shtetëror të datës 1 qershor 1898.

Pashai i përmendur, si rezultat i pjesëmarrjes vullnetare në luftë, si dhe trimërisë së treguar, më datë 14 shtator 1897 u ngrit në gradën e parë të klasës së dytë (ushtarake). Pas vlerësimit të punës (në zyrën e Tanzimatit A. I.), më datë 3 shkurt 1898, Këshilli i Lartë Shtetëror e ngriti në (pozitën) praktikant të shkallës së dytë. Si rezultat i shërbimeve të vyeshme të treguara në luftën e Dömekes (Domoko), në ditët e para të muajit 11 (zilkade), iu akordua medalja shtetërore e gradës së tretë.

Në të njëjtin vit, më 9 shtator 1898 u ngritë në klasën e parë të praktikantit (në zyrën e Tanzimatit A. I.). Vendimi i kësaj ngritjeje është shpërfaqur në pusullën shtetërore.

Para luftës së Domekës, nën komandën e të lartpërmendurit (Hysejn Fuad Beut A. I.) pjesëtarë nga Prishtina dhe Mitrovica si dhe rrethina, në mënyrë vullnetare i janë bashkuar ushtrisë së Sulltanit, duke u sistemuar në regjimentin e parë (të këmbësorisë)⁴. (Kështu A. I.) 1 600 pjesëtarë

³ Zyra e Tanzimatit e themeluar në vitin 1868, ishte pjesë e institucionit të Parlamentit ku në fokus kryesor kishte hartimin e marrëveshjeve ekonomike ndërmjet shtetit osman dhe kompanive të huaja. Pas vitit 1872, mbeti vetëm kjo zyrë, e cila bënte përgatitjen e projektligjeve dhe rregulloreve, po ashtu miratonte edhe emërimin e zyrtarëve të lartë, me përjashtim të valiut (guvernatorit).

⁴ Sipas të dhënave të Ministrisë së Mbrojtjes osmane bëhet fjalë për 2 000 vullnetarë të ardhur


(vullnetarë) i kontribuan në shtimin e numrit të ushtarëve në batalionin e ushtrisë së rregullt, ashtu sikurse treguan edhe trimëri të lartë kundrejt ushtrisë armike. Njëherësh, ishin shumë të disiplinuar ndaj urdhrave dhe kërkesave të komandantëve (që drejtonin operacionet në këtë Betejë A. I.), sa që më 17 maj 1897, arritën që të shtinë në dorë trevën e (quajtur) Ganajk?, Fastr?, Bishot? dhe Masla?. Trimëria dhe kontributi i vyeshëm (i pjesëtarëve vullnetarë A. I.) i tyre, përmendet në Certifikatën e Mirënjohjes (Takdirname) së lëshuar nga ana komandantit të luftës me Greqinë, Ed-hem Pasha të datës 21 maj 1897.

Nga berati (dekreti perandorak) nënkuptohet se të përmendurit (Fuad Pasha A. I.), për gatishmërinë e tij deri në flijim dhe ndihmës së treguar ndaj të plagosurve në luftën e kaluar me Greqinë, më datë 28 maj 1899 i janë ndarë 2 260 kurushë dhe dhurata (hedije).

I njëjti, në korrik të vitit 1900 i është akorduar nishani Mexhidije e klasës së dytë.⁵

I përmenduri më 21 gusht 1902 u emërua si bejlerbej i Rumelisë.

Më 18 shkurt 1904 u dekorua me Medaljonin e Shtetit të Lartë Osman (nişân-ı Âlî-i Osmânî).



Faksimile i dokumentit.

nga këto treva shqiptare, të cilët i ishin bashkuar korpusit të parë ushtarak.

⁵ Medalja.